



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRËN

01 Nr. / Br 193/24

Nr. i fq. / Br. sh - 1 -

Data: / Datum 31.10.2024

VUSHTRRI - VUÇITRËN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: **31 tetor 2024** merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT TË PUNËS
SË KUVENDIT PËR VITIN 2025

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Draft-planit të punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, në përbërjen si në vijim:


- 1.1 Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit;
- 1.2 Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.3 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.4 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit (LVV);
- 1.5 Mensur Kastrati, anëtar i kuvendit (AAK);

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të hartojë draftin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025, dhe të njëjtin duhet t'ia propozojë Kuvendit të komunës për aprovim në mbledhjen e muajit dhjetor 2024.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 194/24
Nr. i fq. / Br. sf -1-
Data: / Datum 31.10.2024

VUSHTRRI-VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17 dhe nenit 40 shkronja(c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"). Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.24/2008"), nenit 352 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë Nr.209/22 të datës 06.09.2022, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **31 tetor 2024** merr këtë:

VENDIM


PËR FALJEN E BORXHIT TË PAPAGUAR PËR TAKSËN NË AKTIVITETE (AFARISTE)

1. Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të papaguar për taksën në aktivitete (afariste), për të gjithë taksapaguesit e Komunës së Vushtrrisë nga data 01.01.2000 deri më 31.12.2017.
2. Me miratimin e këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të papaguara për taksën në aktivitete (afariste), të gjitha borxhet e taksapaguesve, përfitues nga periudha e cekur në pikën 1 të këtij vendimi nga zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenin 5 paragrafi 2, lidhur me nenin 12 të Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31 tetor 2024**, merr këtë:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

1. Me këtë vendim Prof. Ass. Dr. Mentor Hasani, Shef i Departamentit të Historisë në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës, i ofrohet përkrahje financiare në shumën prej nëntëmijë euro (9,000.00€) për realizimin e projektit studimor "Vushtrria në dokumentet osmane", që për qëllim studimi ka historinë e Vushtrrisë gjatë periudhës osmane.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i komunës, kategoria subvencione dhe transfere, të drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe në drejtoritë ku ka mjete të lira.
3. Përfituesi i mjeteve financiare nga pika 1 e këtij vendimi duhet të dorëzojë në Komunë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa brenda 7 ditësh pas përfundimit të projektit raport kthyes për shfrytëzimin e subvencionit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

